

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XXII

Th.

thadër f. «një lloj sqepari i ngushtë e me dy presa, njera si çdo sqepar e tjetra si daltë, i cili përdoret më fort për të shpuar vrima në vegla druri», *thadrój* «punoj drurin a gurin me thadër». Mungon te G. Meyeri. Pas Joklit LKU 157vv. e afër me ind. e vj. *śastrām* «vegël për të prerë, thikë» *śāsati śāsti* «pret, ther», gr. *κελω κελζο* «çaj», lat. *castrō castrāre* «pres, tredh», formuar me sufiks *-dhro-* që përdoret në emra veglash; *-a-*ja refleksi i indoeur. Schwa recundum në shqipen. Etimologji e pranuar te Pedersen Philologica II 112, Walde-Hofmanni I 179, Pokorný I 586, Barić Hymje 10.

Ruhet dhe në kompozitin *krahathadër* «accipiter nesus, një farë sqifteri me krahët posi thadra», ndryshuar dhe në *krahathatë* me ndikim të fjalës *thatë* nëpërmes të një etimologjie popullore. Të tilla emërtime të shpendve ka dhe në gjuhë të tjera; khs. rus. *кóса* «pendët e bishtit të gjelit», në të vërtetë shumësi i *kosá* «kosë për të kositur». Në të tilla rrethana dhe gr. *ὄρνις* «lloj orrli» pas mendimit tonë nuk do marrë dhe aq si «krahëshpejtë» *sesa* më fort konkretisht si «krahëmprehtë», koncept i afër me të shq. *krahathadër*. E njëjta gjë do përsjatur atëhere për lat. *accipiter* «skifter, fajkua». Meqë ky kompozit përmban në pjesën e parë *acu-* si në *acutus* «i mprehtë» etj., edhe ky emër shpendi ka mbase në thelb kuptimin «krahëmprehtë» më fort se «krahëshpejtë, shpejtfluturues». Një tjetër kompozit i *thadër-s*, me *kë-*, është *këthadër*, te Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 73. Prej kësaj duket të rrjedhë fjala *kthetër*, si një shumësi metafonik i singularizuar. Kjo ndihet dhe me trajtën *kthedër*, e cila afrohet më shumë me *këthadër*. — Spiegimi i gjertanishëm i *thadër-s* është fonetiki dhe kuptimisht i patëmetë. Me gjith'atë ekziston mundësia e një afërie tjetër. Mund të kemi të bëjmë me një rasë metateze të grupit *rdh* në *dhr dr*, si në *badhër badër*: *bardhë, hudhër hudër hurdhë*; gr. *σάρδον*, *mjedhër mjedër*: *mjerdhë, sh. badër badhër e mjedër*. Kështu arrihet te një **thardhë, thardë*, te një postverbal i **thar*, trajta e hershme e *ther* (si në *tharbët tharm* etj.) formuar me sufiks *-dhë -dë*. Për këtë formant (*shpardhë, vodhë vadhë* etj.) sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 31.

thaj. Këtë fjalë G. Meyeri (f. 88, AS III 43 e 92), bashkë me rrjedhojat e saj: mbiemrin *thatë*, mbiemrin e substantivuar *i thatë* shm. *thëtëra* «pezmatim me qelb i gjëndrave t'nyndyrës ose i rrënjëve të qimeve të lëkurës, birth, çiban», *thatiq thatim* «i thatë nga trupi», *thatësinë thatësirë* e *përthahem*, e vendon te grupi lit. *saūsas* «i thatë» sllav. e vj. kishtarë *suchъ* «i thatë», ind. e vj. *śōṣaḥ* «terës, që than», gr. *αῦο*

(nga *sausō) «thaj», lat. *sūdus* «i thatë, i kthillët (për motin) etj., baza e fjalës shqipe një denominativ *saus-sniō. Mendim i pranuar kudo: sh. Brugmannin IF 1,118, Boisacqun 102, Walde-Pokornyn II 447, Walde-Hofmannin II 624, Joklin LKU 261 shën. 2 e IF 43, 49, Tagliavinin 300 v., tani sëfundi Hofmannin GEW 28 v., Vasmerin REW III 54 e Fraenkelin 766, të dy dhe me literaturë.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LXXIX=LXXXXIX, Marku 9,17; XXX, Luka 21,26; LIX/2 = LXIX/2, Gjenez 1,10; LX/2 = LXX/2, Gjenez 7,22) e djerie qet shkumënë për goje, e sokullen mbë dhambë të tî, e thahetë «et spumat, et stridet dentibus, et arescit»; Nierëzitet kanë me u thām për umnert e për të prurititë qi kâ me ardhunë ndër për gjithë shekullit «arescentibus hominibus prae timore et expectatione»; E grishi Zotynë të thatëtë dhë, e të mbëljedhunitë e ujënavet grishi dët «Et vocavit Deus aridam, terram, congregationesque aquarum appellavit maria»; e gjithë ato kafshë qi shpirt të gjallë patnë ndë vetëhenë, me gjithë ato qi mbë të thatë klenë, u bduorë e u përfaruarë «et cuncta, in quibus spiraculum vitae est in terra, mortua sunt». Bardhi Siccescere Me u thām, Siccitas Të thātë, Siccare Me thām mbë diellët, Siccus Thātë, thithunë, tērunë, Torridus Thātë, ligunë. — Përveç thatiq e thatim ka edhe thatik, thatanik e thatush. Geg. edhe thatinë për «thatësinë» dhe jam thashëm «jam esëll, s'kam shtirë gjë në gojë». Kësaj i përgjigjet prej tosk. jugore këshu thatë do vemi? d.m.th. «pa ngrënë a pa pirë gjë rrugës». Kuptimi i tokës si e kundërta e ujit edhe te Mitko (f.9), s'këndon bretkosi mbë të thatë «Δέν τραγουδά βάρραχος εις τήν ξηράν». ». — Etimologjia e gjertanishme e fjalës në thelb gjan të jetë e drejtë, po për mendimin tonë do një modifikim. Krahas me thaj ekziston dhe thak, në shprehje si ja thaku paratë «ja mori paret (me donjë hile», në Gjirokastër) gjetkë ja thau paret. E krahas me thak ka thek (bukën). Kështu forma bazë e fjalës gjan të jetë thak, dhe thaj të ketë dalë nga *thaknj. Atëhere kjo fjalë mund të ketë një lidhje më të ngushtë me disa fjalë të greqishtes: σαυκός ξηρός Συρακόσιοι, σαυχμόν σαχνόν, χαύνον, αθηρόν, άσθενός (Heziku), m'anë tjetër αύχμός «thatësirë» αύχηηρόσ «i thatë», të cilën e lidhim vërtet me αύ. «thaj», po mbi një bazë *sauk-s-m-. Për *thaknj thaj mund të mendohet si bazë parashqiptare një *sauk-niō. Për praninë e një rrënje *sau-k- pranë *sau-s- si variante e kësaj, si mendon Charpentieri, në lidhje me fjalët greke sh. Walde-Pokornyn II 447, Pokornyn I 881, Hofmannin GEW 29, të cilët çfaqin rezervë. Fjala e shqipes mbase është në gjendje të sqarojë gjer diku dhe punën e burimit të fjalëve greke. Veçanërisht σαυκός «i thatë» i dialektit të Sirakuzës mund të ishte një relik i ilirishtes së Italisë ose i ilirishtes së dorishtes. Për σαυκός khs. tani M. Schmoll, Die vorgriechischen Sprachen Siziliens 57. Më anë tjetër te një bazë sas- nga -saus- «të thatët, kontinenti» duket se na shpie emri i ishullit të Sazanit, në kohën antike Sason Σασών. Sh. vrejttjet tona në SCL X 4 558, BUST SSS 3, 1963, 115. Për këtë emër gjeografik sh. Krahen GN 35.

thalb m.: sh. thelb.

thanë f. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri 88 lëkundet midis krahasimit me lat. *cornus* gr. κόνος «thanë» që i afrojnë me emrin e bririt, cornu κέρας, e një tjetri me verbin thaj përbrenda shqipes. Pedersen (KZ 36,332) i shton këtij barazimi dhe irl. *congan* «bri», duke e çuar thanë-n te një formë bazë *thangnë, sh. dhe KG I 157v.

Ashtu afërsisht edhe Zupitza KZ 36,60v. e më vonë dhe Bariçi I 9v., Hymje 52, të cilët bëjnë vetëm një modifikim të bazës. Afrimin e *thanë-s* me fjalët greke e latine e kundërshton me të drejtë Boisacqu 509, për arsye fonetike, dhe me të bashkohet dhe Walde-Pokorny I 411. Hojki (te Walde-Hofmanni I 276v.) bën një afrim përbrenda shqipes me mbiemrin i *thantë i thajtë* «hollak, po i fortë e me shëndet të mirë» e me *i thatë* «birth, çiban, një e dalë», e në rendin indoeuropian me lit. *savnas* «i kërthnестë, i vrazhdë, i zoti», ind. e vj. *sávas-* «fuqi, burrëri». Këtë afrim e pranon dhe Pokorny I 593.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Bardhi, Cornus, corniolo *Thana*. Me sufiks dyfish *-uk-ël* (si te *dardhukël*) *thanukël thënuke*, te Bashkimi *thnugël* «Cornus sanguinea», te Ed. e Re (II, Ser. III, shkurt 1931, f. 52) *thanulë* «thanë që nuk ban pemë»; i thonë edhe *thanë-qere*. (Lako IJ XX VII 106, Mitrushu 314), edhe *thanuqe; rrush thanës* «lloj rrushi me kokërr picigjatë», te Bashkimi *thanc* m. «nji farë rrushit i zi»; *thanas-t* mpl. e *thanishtë* f. «vend me thana». Prej *thanë-s* janë formuar dhe plot emra visesh, si *Thana* në rreth të Lushnjes (Seiner 98), *Thânëz* në Mirditë (D.P. Suli, Përparimi VII 154) e afër Giadrit (G. Gurakuqi Leka V 218), *Qafë-Thanë* midis Elbasanit e Pogradecit. Për të tjera emra, si *Thana Bulgërit, Kodër e Thanës, Lugu i Thanës, Maj'e Thanës, Thanishtë* etj. sh. Gazetteer 180.

Nga etimologjitë e gjertanishme të fjalës, krahasimi me lat. *cornus* e gr. *κόρινος* bie a priori, sepse te këto kemi të bëjmë me reflekse vëlaresh indoeuropiane, te *thanë* kurrsesi me një tingull të tillë. Afrimi me *i thantë i thajtë* është në vetvete i drejtë, po do kuptuar kështu që mbiemri ka dalë nga *thana* si simbol i fuqisë e i shëndetit e jo anasjelltas. Nuk ka lidhje kjo fjalë as me *i thatë*, që paraqet substantivimin e mbiemrit *i thatë*, ky në thelb particip *i thaj*, me të cilën *thanë* nuk ka të bëjë. Mbetet i drejtë afrimi me irl. *congan* «bri». Khs. përshkrimin e thanës nga Teofrasti (te Hahni, Kulturpflanzen und Haustiere 4 327): «druja e thanës është pa palcë e e fortë, në dendësi e në të fortë e përgjashme me bririn», e me këtë dhe lat. *cornus* «thanë»: *cornu* «bri». Si e kemi shtjelluar dhe në BSS IV (1953) 34, *th-*ja e *thanë-s* reflekton një *k* indoeuropiane palatale, pra baza e saj është **kongā*. Nuk është nevoja të paravendohet — me Pedersenin — një **thangnē* si bazë e *thanë-s*, se edhe vetëm grupi *ng* i periodës proetnike ka dhënë në shqipen një *n* (edhe në toskërishten), sikundër e kemi shtjelluar në vendin e përmendur.

thartë (i), *i tharbët*. G. Meyeri (f. 88, AS III 13,87,V 75) e jep me trajtat *thartë tharëtë, tharëtónj, thartirë e tharbët tharpt*, niset nga kjo e fundit, dhe këtë, si refleks të një baze **sarbas* **sarva-* e më tej **korvos*, e përqsas me gjerm. *herb* «i athët» e *Harm* «brendë, helm» që shkon me sllav. *sramъ* «turp, mbarë». Pedersenin (KZ 36,332) e lidh me lat. *acerbus* «i tharbët», po në një trajtim më të vonë të fjalës latine (Mém. Soc. Ling. XXII, 1922, f. 5) nuk e përmend më fjalën e shqipes; prandaj, si vren me të drejtë Jokli (WuS XII 90), duket të ketë hequr dorë nga ai krahasim. Jokli vetë përfshin te *i thartë* edhe emrin *tharm* «brumë i thartë, majë» bashkë me *tharb* «acid» dhe e afron fjalën me gjithë variantet e saj me lit. *szármas* let. *sařms* prus. e vj. *sirmes* «finjë» e me gjerm. *Harn* «shurrë». Mendim i pranuar te Walde-Hofmanni II 497. Restelli (Rendic. Ist. Lomb. di Scienze e Lettere 91,538v.) *tharb-in* e bie të ardhur prej një baze * *hur-bho* dhe si të tillë e afron me gjerm. *sauer* «i thartë», lit. *súras* «i ngjelmët», sllav. e vj. kishtare *syръ* «djathë» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Budi (DC 116) *Mënia, e cia shemënjien uthullësë, qi aqë sã mã e (e) fortë e e tharëtë qi ashtë...* Bardhi Saevire, incrudelire *Me u tharëtuem*, Saevitia *Të tharëtitië*, Saevus *I tharëtë nieri*. Nga *tharë*, përveç verbit *thartoj tharëtoj dhe tharitirë-s* që u përmendën më sipër, janë formuar dhe g. *tharsinë* t. *tharësirë* «tharitirë», g. *thartinë* «lëndë a lëng i thartë që i shtien gjellës për t'i dhënë shije të thartë» (në Gjirokastër *thartilë* «tharitirë; thartinë»), *thartim* «shije e thartë; të thartuarit», *thartore* «Rumex acetosella, uthullishte», *thartushë* «Polygonum», *thartuer -ori* «hirrë e thartuar që e hanë pas dy-tri ditsh», si mbiemra *thartanik* «si i thartë, i athët» *thartosh* «si i thartë në gojë, thartanik»; me -b *tharb* m. «tharm» me verbin homonim *tharb* «thartoj», nga *tharbët* verbi *tharbëton* «thartohet vera e ëmbël e bëhet uthull, fermenton». Një vështrim krahasues i gjithë trajtave të fjalës tregon se i *tharëtë* e *tharëtuem* e autorëve të vjetër të Veriut, e cila ruhet dhe sot në geg. jugore, si trajtë më e plotë dhe e dëshmuar më parë, është primare ndaj së sotmes i *thartë thartoj*. Më anë tjetër i *tharëtë* duhet të merret si primare dhe ndaj së sotmes i *tharbët*, e cila nuk haset as tek ata autorë as në kolonitë e Greqisë e t'Italisë, me gjithë se *tharb* e *tharm* në vetvete mund të jenë mjaft të vjetra në gjuhë. Morfologjikisht i *tharëtë* paraqitet si një mbiemër verbal a një particip i adjektivuar -më -të, i llojit të i *djegët, i ngritë, i shuat, i thatë* etj., të cilat trajtohen te Xhuvani-Çabej Prapashtesat 90. Kështu te kjo fjalë kemi të bëjmë në krye të herës me një verb. Ky është *thar*, në Mirditë pas Donisë (Cirka II 217) *me tharë tamblin* «me i qitë të tharbtin për m'e xanë kos», poashtu pas Gazullit e *thara tamblin*, në Pukë *me përtharë* «me egërcue, keqsue, gjerm. erbittern, sich verschlummern, it. esasperare, aggravare, peggiorare». Këndej shihet se baza e fjalës është *thar* dhe se prandaj gjithë spjegimet që nisen nga zgjerimet sufiksale të saj, si *tharb tharm* etj., nuk mund të qëndrojnë. *thar* është forma e vjetër e *ther*, ashtu siç është *dardh* ndaj *derdh*, *ardhur* ndaj *erdha*, *shkal* ndaj *shkel*, sh. këto fjalë. Thelbi kuptimor i kësaj fjale është pra «pres», *thar tamblin* është «pres qumështin, e bëj të pritë, të fermentohet»; i *thartë* i *tharbët* është «që pret, i mprehtë»; prandaj dhe *dimër i thartë* «dimër i ashpër, dimër me të ftohtë që të pret» e *fjalë të tharta* «fjalë të ashpra, therëse, që lëndojnë tjetrin». Nga *thar*-i i këtij kuptimi konkret është formuar dhe *tharakác* m. «një lloj cape», te Cordignano «piccone, kazmë, ternagop», një formim *thar-ak-ac*, me lidhje dy sufiksesh. Emërtimi i së thartës nga ideja e të pritë a të therurit është mund të themi një dukuri e përgjithshme. Mjafton të përmendim lit. *kiřpti* «me u thartue» dhe «me pre, me qethë», *kiřsti* «me u idhtue» dhe «me i ra (me sëpatë, me shpatë etj.), ku hyjnë dhe *pienas sukirpo* «qumështi u thartua» e *kartùs* «i idhët», Fraenkel 258; serbokr. *bridak* «i mprehtë; i thartë» rus. *bridkoj* «i fortë, që të pret» (për erën): *britva* «brisk» *briti* «me pre, me rrue», Berneker I 86, Vasmer REW I 123. — Për rum. *sarbad salbed* «i zbetë, i irun» mendimet ndahen. Një lagje dijetarësh (Puşcariu Fjal. et. 1521, Densusianu Hist. la roum. I 308 Papahagi 914 e të tjerë), e bien të ardhur prej një lat. **exalbidus* të rindërtuar. Candrea-Densusianu përkundrazi (Nr. 42) *sarbād* «i thartë, thartosh, i pashije» (për qumështin) e spiegojnë nga shq. *tharbët*, dhe *sarbād* «i zbetë, i irun» nga lat. **exalbidus*. Sipas Scribanit (Arhiva XXVIII 240) *sarbād* me të gjitha kuptimet e saj rrjedh prej shq. *tharbët*. Rosetti ILR II⁴ 120 vetëm për *sarbād* «i thartë» pranon një lidhje me *tharbët*, për *searbād* «i zbetë, i irun» burimin e gjen në lat. **exalbidus*. Sh. edhe vrejttjet tona (Rev. Shkencore e Inst. dyvj. Shkodër I, 196, Z.f. Balkanol.

II 27v.) në lidhje me paraqitjen e shq. *i tharbët* pa artikull në rum. *sarbäd*.

thek «rreshk bukën në zjarr», *thekem* «ngrohem mirë në zjarr a në diell». G. Meyeri 88 e bie të ardhur prej it. *seccare* «thaj», me gjithë se në një tjetër vend të Fjalorit etimologjik (f. 440) ai nga it. *secco* «i thatë» nxjerr fjalën *cekë, i cekët*. Brugmanni I 848 *thek* e spiegon nga it. *secco*, po Meyer-Lübke Gr Gr I² 1053 e qet prej lat. *siccare* «thaj, me tha». Një fjalë vendi të shqipes gjen te *thek Bariçi* I 13, të afër përbrenda shqipes me *thëngjill* e me *do(l)lofangë* «xixëllojë» të shqipes së Greqisë, e më tej me ind. e vj. *sōcati* «ndrit, shkëlqen, digjet», pers. *soxtan* «me ndezë, me u djegë» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del edhe me trajtat e zgjedhura *thekërroj, thekërris, thekërric*, kjo e fundit mbase një denominativ i *thekërricë-s* «felë bukë e thekur». Një nomen agentis më -*ës* është *thekës* m. «përdorse (një lloj skare?) për të thekur bukën», po te Godini «Röstpfanne». Mendiimi i burimit të fjalës nga it. *seccare* nuk qëndron as fonetikiisht as morfologjikiisht, do të pritej një refleks me *s-* ose *sh-*, jo me *th-*, e me *mba-*rim me *-oj*. Pokjo vrejtje vlen dhe kundra spjegimit nga lat. *siccare*. Forma *thek* si verb, sidomos me mbarimin konsonantik, me mungesën e një sufiksi verbal, dëshmon qartë se kemi të bëjmë me një fjalë vendi e të një kategorie verbale shumë të lashtë; sh. për këtë Pedersenin Rom. Jahresber. IX I 211 e Joklin Slavia XIII 299v. Pas gjithë gjasësh *thek* është forma metafonike e *thak*, e cila përdoret me kuptimin «thaj» në shprehje si *ja thaku paratë* «ja mori paret (me ndonjë hile)»; khs. për një të tillë metafonji verbale *derdh* edhe *dardh, shkel* edhe *shkal, erdha e ardhur, thak* gjan të jetë baza e *thaj*, kështu që *thek bukën* do të thotë në thelb «thaj bukën në zjarr». Për lidhjen etimologjike të *thak thek* dhe *thaj* me gr. *αυτός ξηρός Συρακόσιοι, σαυχρόν σαυχρόν, αύχμός* «thatësirë» etj. e për burimin mbase ilir të *σαυρός* në dorishten e Sicelisë sh. *thaj*. — Në përdorimin gjuhësor *thek* ka marrë dhe kuptime afektive; khs. geg. *thek zanin* «e mpreh z». *me zâ të thekshëm, gojë e thekshme* (Gazulli), *thek hapin* «shpejtoj hapin», *thek këmbët* «nxitoj, u grah kambëve», *thekja kams!* «via t'affretta!» (Junggu), prej nga dhe *thekatuëshëm* «me të shpejtë, me vrap» te Fishta, te Bashkimi 538 «fretolosamente e con ansia»; për toskërishten khs. *është i thekur ai* «është dinak e di shumë shtigje, është dreq» (Gjirokastra), *i ka të thekura* (scil. fjalët) «i ka (fjalët) me thumba» (Përmet, M. Totoni). Mbi këto dëshmi duket se me *thek* shkon edhe *thekem* «mallëngjehem, prekem» bashkë me *i thekshëm* «mallëngjyes, prekës» (Junggu, Bashkimi), e mbase dhe *theke-t* «djalli, sherri» (*ka theke shum*), *i thekët* «që ther, therës», *miell i thekët* «i bluem trashë, bullgur», *bukë e thekët* «qi vret në të hângun» e *bar të thekmit* «Polygonum aviculare» që jep Gazulli kryesisht për Malsi të Madhe.

thekën thekër f. Për këtë fjalë G. Meyeri (f. 88, Ngri. Studien I 46 shën. 2, III 59) nisat nga një lat. *sécale* (për *secale*) si bazë, dhe mendimi i tij pranohet pothuajse përgjithësisht: Pedersen IF 5, 82, Helbig 79, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1044 e REW 7763/3, Puscariu EW 1493, Spitzer Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 315, Weigand 91, Jokl Albanisch 130, Bariçi Arhiv za arb. starinu I 208, tani sëfundi Battisti 92.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi jep gabimisht *Secale Tërshana*. Rrjedhoja janë *theknore thekërore* f. «arë e mbjellur thekër» e *bukë e thekërt*.

Sikurse shënohet shkurt dhe në Li.Posn. VIII 92 e në Revue de Linguistique VII 1 187 v., edhe *thekën thekër* është një fjalë vendi. Si e pa Jokli, është *theknat thekrat*, plurali i *thek*-ut, përdorur si singular; khs. *thakët e grurit* «halat e kalliut të grurit». Kemi pra të bëjmë me një plural të singularizuar.

thelb thalb m. «gjysma a një e katërta e bukës së arrës; fara e mbyllur brenda një lëvozhge; fara e mbyllur brenda një lëvozhge të fortë që kanë disa pemë si kajsia, arra, lajthia, bajamja etj.; seicili nga zhardhokët e vegjël që përbëjnë kokrrën e hudhrës», figurshëm *thelbi i kësaj çështje*, nga *thelbi i zemrës*. G. Meyer 89 e jep me trajtën *thelp*, shm. *thelpinj-të*, mendon — me rezervë — një metatezë **thepl-*: *thelp*, dhe e afron kështu me friul. *sepe* «thelb, bërthamë». Bariçi (I 30) bën një lidhje me *bërthamë*, duke e nxjerrë *thamë-n* e kësaj nga një **thalm* e duke e çuar *thelp-in* te një bazë **stha^xln-bha^xr*.(!)

Fjalë e mbarë gjuhës. Edhe e arbërishtes së Kalabrisë, në Acquaforsa *thëlbi* «uno spicchio d'arancia», një *thelb hūdhërje*, Rohlf's AIS VII 1273 e 1370. Çam. *thelpi*, shm. *thelpitë* (Pedersen 121) ka dalë nga singularizimi i shm. *thelpinj*, është pra një shumës i singularizuar. Një gjë të tillë gjan të paraqesë edhe *thelb-i*. Geg. veriore ka *thalb*. Kjo duket të jetë forma origjinale e fjalës, e *thelb* shumësi metafonik i singularizuar, poashtu si *rreth*, *thes* etj., sh. vrejtjet tona Li.Po. VIII 90v. Një zgjerim i *thalb-it* me *-së* është *thalbsë* që gjindet te Manni. Me *thelb* gjan të lidhet m'anë tjetër *thelbël* «shkimëz, piurrlë, foje guri, e çame si rriskë, gur i vogël si petë» që jep Gazulli, në qoftë se kjo nuk vjen nga *thyej thej*. — Etimologjia e G. Meyerit nuk mund të mbahet, për arsye të formës. Poashtu qëndron puna me kombinimin e Bariçit. Për hetimin e burimit të fjalës mund të ndihmojë kjo, që emërtimet e thelbit kanë dalë shumë herë nga ideja e të plasurit, të çarit; khs. nga shqipja vetë *ther-i* në Pukë «thelbi», te Gazulli. Në këto rrethana, në qoftë se për *thalb thelb* pranohet një ndrim *f:th* përbrenda shqipes e më këtë një **falb* **felb* si formë bazë, mund të mendohet një burim prej indoeur. **sphel-* «çaj, këput», pra një afëri me ind. e vj. *phālati* «pëlçet, çahet», gr. *σφαλάσσει* *τέμνειν*, *κντείν*, gjerm. *spalten* «me çaj», prus. e vj. *spelanaxis* «ashkël» etj. Edhe te *thellë* pranë *fellë*, e cila buron po së andejmi, vihet re një ndrim i dy spirantevet, sh. këtë fjalë. Ndërkaq ndonjë trajtë me *f-*, teoretikisht e mundshme, gjer më sot nuk është vërtetuar në gjuhë. Prandaj fjala mbetet dorajdorën me gurrë të errët.

thelë f.: sh. *felë*.

thellë, fellë (i) «që e ka fundin larg nga syprina, jo i cekët; me ngjyrë të mbyllët», *thellë* «drejt fundit, mjaft brenda», për ngjyrë e *kam pjekur thellë kafënë*; *thellësi* f.; *thellësirë thellësinë thellinë* f. «vend i thellë në ujë», *thelloj* «e bëj të thellë, e ha, e gërryej, më shumë nga përbrenda; e bëj më të mbyllët nga ngjyra», i *janë thelluar sytë* «i janë futur përbrenda»; *thellësisht* neologjizëm. G. Meyer (f. 88, AS III, 13,90) lëkundet midis një afrimi me gr. *κο λος* «i zgavërt» lat. *cavus* etj. e një tjetri me ind. e vj. *šuši-* «zgavër, gropë». Nga këto dy krahasime është pëlqyer i pari: Pedersen KZ 36,332 (baza e *thellë-s* **Kovilo-*), Boisacq 481, Walde-Pokorny I 366, Walde-Hofman I 191 Pokorny I 593, Hofmann GEW 151. Vetëm La Piana (I 71 shën. 1) e përqs fjalën me gr. *θέλυμα* shm. «fondements (des choses), homer. *προ-θέλυμος* «extirpé

jusqu'à la racine», duke gjetur te *thellë* një element kentum të shqipes.

E mbarë gjuhës. Buzuku (XIII, Psalm 129,1; LIII, Gjoni 4,11) *N së thellashit vise u tÿ thira, Zot* «De profundis clamavi ad te, Domine», e *pusi anshtë fort i thellë* «et puteus altus est»; Budi (DC 95, RR 68, SC 157) *kafshë fortë thellë e të nalta; e t i banjë të thellë të falë, e ndër e reve-rencie. . . ; parë se më kanë shtim rranjë të mjet thellë ndër zemërë*. Edhe e shqipes së Greqisë: në Markópulo të Atikës edhe çoj një shpélëzë jo shumë të thellë βροχη μιá απη-λιά όχι πολύ βαθιá (Sotirios, Laographia I 88), dhe te Weigandi BA II 172; në Salaminë i *thellë*, si neutër i substantivuar të *thellë-t* «thellësia», Haebler 58,79,101,102. Po në Piana të Sigelisë për «i thellë» thonë i *çumbët*. Në një pjesë të mirë të geg. veriore mbizotëron kompoziti me *kë-*, i *kthellë*, në Dibër me metatezë i *thkellë*. Del që te Bardhi: Profundus *Nkëthellë* (Profundum *Dët*), e te Bogdani (II 54, 13): *u largue barka prej së kthelli* «si discosto la barca verso il pelago»; Junggu i *kthell* «profondo», *kthellim* m. «profondità, abisso», Cordignano edhe *k(ë)thellinë* e *k(ë)thelltinë* f. po me atë kuptim, Gazulli për Malsi të Madhe *kthellojë* f. «vend i kthell nën dhë; burg, haps, me shtë në *kthellojë*; sh. për prefiksion *kë-* te kjo fjalë Joklin Rev. Fil. II 258 dhe Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 72v. Aty duket të hyjë edhe emri i krahinës *Kthellë* e *Thkellë*. Me *pa-* është formuar *pathellim* m. «humnerë», te Cordignano² s.v. *abisso*; khs. përkuptimin intensiv të *pa-së* gjerm. *Untiefe* «vend i thellë fort»: *tief* «i thellë».

Për hetimin e burimit të fjalës do caktuar më parë se nga dy kuptimet e dy trajtat kryesore që ka sot, cilat janë primare e cilat janë rrjedhoja. Nuk ka dyshim se nga «i thellë» e «i mbyllët, i errët» së parës i përket parësia; kuptimi i ngjyrës së errët buron shpeshherë nga ai i së thellës, sepse ç'është thellë, i paraqitet syrit dhe si e errët. Përsa i përket fonetikës, do thënë se fjala për nga konsonanti nistor përdoret me dy trajta kryesore, *thellë* edhe *fellë*. E para ka një përhapje më të madhe, po dhe e dyta nuk është rrallë, përdoret dhe në Veri e në Shqipëri të mesme, edhe në Jugë, këtu sidomos në tosk. lindore. Kristoforidhi jep *thellë* për toskërishten e për shkoderanishten, *fellë* për gegërishten, *ay kërkon të gjejë të fellat e dheut, fellësinë* për «thellësinë» *felloj* për *thelloj*. Ashtu dhe Weigandi, e për Gjakovë Arbanasi. Një emër kullote *Lugi i Fellë* gjindet në Kallë Sillovë të Dibërs (P. Daka). Krahasimet e gjertanishme të fjalës paravendojnë si trajtë primare atë me *th-*, e këtë mendim kemi ndjekur dhe ne në BUST SSS XI 1 (1958) 66. Nderkaq *thelloj* «e bëj të thellë, e ha, e gërrij me shumë nga përbrenda», te Godini «zgavroj, lugos, gërmoj, gjerm. anshöhlen», bashkë me *udhë* e *thellë* «Hohlweg» poaty, tregojnë që kuptimi bazë i fjalës është «zgavriq, i zgavërt, golle». Atëhere *fellë thellë* shihet se bën pjesë në një grup fjalësh ku hyjnë ndër të tjera: *gërfëj* e *zgërfëj* shm. «shpella me dy grykë, hyhet më një anë e delet më tjetrën», njëjës *gërfyll* po me atë kuptim, *zgafelle* f. «galeri; tunel; shpellë», *zgafulló* «hap një gropë», *fyell* që ka si kuptim të parë «zgavër, gyp» (*fyell i këmbës, fyell i koskës*, te Buzuku *fyell n mjalti* «favum mellis»), *fyl* «fyrbë, i zgavërt», *fyllc* «kallam» *fyshkem, fishkem, fyshtër* «Forsythia europaea, boshtër», *ful* fem. *fule* «fyl, fyrbë», *fejjet* e *hundës* (shumësi i *fyell-it*), *feçkë* «zgjatim i turirit të derrit, i hundës së filit e të disa insekteve; cunnus, pudendum muliebre». Ky grup fjalësh i shqipes i përket rrënjës indoeur. **sp-(h)el-* «çaj, këpus»: ind. e vj. *phálati* «pëlçet, çahet», gr. σφαλάσσειν τέμνειν, κεντείν, gjerm. *spalten* «me ç», prus. e vj. *spelanxtis* «ashkël» etj. Aty hyn pas mendimit tonë edhe gr. σπήλαιον σπήλυγε «shpellë», fjalë gjer

sot e burimit të errët; për kuptimin e saj khs. shq. *gërfëj* e *zgafelle*. Nga reflekset shqiptare të indoeur. **sp(h)el-e-në* e kryehershme e ruan *thellë fellë*, bashkë me *zgafelle* e me shumësin e *fyell-it*, *fej-të*, *feje-t*, me *gërfëj* *zgërfëj* e me *feçkë*. Diftongim të *fyell* me kompozitin e tij *skërfyell* «rryl, gabzherr». Me monoftongim të *ye-s* së *fyell-it* në gegërishten paraqitet *fyl*, *fyllc*, *fyshkem fishkem*, *fyshtër*; me ndrim *y:u fyl ful*. Sikundër shihet, kjo rrënjë është bërë shumë produktive në gjuhën shqipe. Për *palë*, *plis* e *plish*, të cilat e lidhin tek e thjeshta indoeur. **p(h)el-* (pa *s-*). sh. këto fjalë.

thembër f. «pjesa e mbrapme e këmbës; pjesa e mbrapme e çorapes; ana a qenari i bukës a i lakrorit». Ndërsa Kamarda (I 62) mendonte një afrim me gr. **ὀστρον** «pëllëmbë e dorës, shuall i këmbës, sipërfaqe e detit», G. Meyeri (f. 89; IF 3, 64; AS IV 120) e jep (pas Rossit dhe me kuptimin «gilcat e gjurit» dhe e bie të ardhur prej lat. *femur* «kofshë», duke krahasuar për ndryshimin e kuptimeve gr. **πρόνα** «thembër; shalë» e got. *fairzna* «thembër»: ind. e vj. *pārśni-* «thembër; shpinë» e lat. *perna* «përshutë». Këtë spjegim mezi e pranon — me rezervë — Meyer-Lübke Gr Gr I² 1053, si për punë të kuptimit, si për punë të mungesës së fjalës latine në gjuhët romane. Poashtu dhe Tagliavini 298. E miratojnë përkundrazi Helbigu 79 dhe Weigandi 92. Si etimologji fort e dyshimtë jepet prej nesh, BUST SSS XII 1 (1958) 67, Revue de Ling. VII 1 194.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku (XLVI, Deuteronomi 11,24): *E gjithë dhë qi thembra juoj të shkelnjë, të jetë tajtë* «Omnis locus quem calcaverit pres vester, vester erit», shkruar *thembra*, me *n* hiperkorrekte, si te *anblë*, *shkanbit* etj. Bardhi Calcaneus *Thembra*. — Burimi latin, fort i dyshimtë në vetvete nga puna se *femur* nuk rron më në gjuhët romane (khs. edhe Meyer-Lübken REW 3240), bëhet edhe më i dyshimtë për shkak se shqipja trashëgon prej latinishtes si emër të kofshës fjalën *coxa* (kofshë), poashtu si gjuhët romane. Kundra burimit latin, nga pikëpamja e shqipes, përveç këtyre arsyeve, flet edhe kuptimi i fjalës, i cili largohet mjaft prej atij të lat. *femur*. Po ajo që e largon *thembër*-n nga fjala latine në mënyrë të prerë, është se përveç pjesës së pasme të këmbës (e prej këndeje të çorapes) shënon dhe anën e bukës a të lakrorit, e përgjithësisht kotheren e bukës. Ky përdorim ndeshet që te Bogdani (II 40,9): *përse vollëndohen së paku me një thembër bukë mellakuqe* (sic!) «perche si contano del poco, con un tozzo di pane di sorgo». Përdorim edhe sot i gjithmbarshëm, si në Jugë (Përmet e gjetkë), si në Veri, në Pukë pas Gazullit *ma nep një thëmbër bukë*. Në Gjiro-kastër e gjetkë *themër e lakrorit*, në Elbasan *themër e lakrorit* i thonë qenarit rrotullar e më të ngritur të lakrorit që piqet në tepsi. Tasja ka *thembrë mbë thembrë e ka punuar arën akëcili* «s'i ka lënë cep, s'i ka lënë pëllëmbë pa punuar». Një vështrim krahasues i dy kuptimevet kryesore të fjalës tregon se emërtimi i pjesës së këmbës nuk mund të jetë primar, po edhe ai i anës së bukës nuk gjan të jetë. Të dyja domethëniet bashkohen te ideja e diçkaje të lakuar e të kthyer. Kjo u specializua pikësepari në «qenar i bukës» e më tej në «kothere bukë, një thelë bukë»; khs. për këtë *kothër* «rreth i shoshës»; rreth i lakrorit» e *kothere* «kore buke e thatë, një thelë bukë», dy trajta të një fjale të vetme. Zhvillimi kuptimor i mëtejmi në emërtimin e një pjese të këmbës gjan të jetë kryer në fillim me shprehjen e plotë *thembra e kambësë*, të cilën e dëshmon Kristoforidhi. Aty, me anë të një elipse, mbeti *thembra* si emërtim i pjesës së trupit, poashtu si *rrashta* nga *rrashta e kresë*. Kuptimi

i kryehershëm i fjalës duket të ruhet te verbi *me thembërzue* «m'e sjellë një drû, një gur në trajtë thëmbre tue e latue», *me thembërzue hardhin* «m'e vû në gropë tue e sjellë si thëmbren», që jep Gazulli për Malsi të Madhe.

thep m. «maja e mprehtë e shkëmbit; majë (guri), majë e mprehtë», *thepis* «bëj me thepa, e bëj me majë». Mungon te G. Meyeri. Jokli (Studien 20 e 117, Balkangerm. u. German. im Alb. 125v.) e merr prej Junggut e Bashkimit («punta, roccia», «roccia o sasso che termina in punta», *me thepisë* «puntare», «rendere ispidò, puntare») edhe prej Fishtës (*Mal mi mal, ky, ravës s'thepisme*), dhe e afron me lat. *cippus* «hu me majë, shtyllë e drunjtë a e gurtë e me majë, gur sinorësh, shtyllëz varresh» (në gjuhët romane edhe «shkëmb») e me ind. e vj. *sēpaḥ* «penis», baza e fjalës së shqipes sipas tij një **Koipo-*. Përbrenda shqipes e bashkon me *cep* «skanj; qoshe, kënd i dalë (i murit); sup; sqep; majë (shkëmbi a muri)» *cepój* «godit, qëlloj» e me metatezë *step* «thep, majë», duke parë te *thep* një zhvillim fonetik të *cep-it* me ndrimin e afrikatës në spirantin interdental (c:th) të konstatuar prej tij. Afrim i pranuar te Walde-Pokorny I 364 e II 545, Walde-Hofmann I 219, Pokorny I 543, Hofmann GEW 319, Vasmer REW II 637. Një tjetër afrim të *thep-it*, me arm. *sep* «shkrep me majë, thep», bën Lidëni, Göteborgs Högsk. årsskrift 39 2, III (52vv.), sh. Joklin IJ XIX VII 189. Këtë krahasim e gjen të vështirë Walde-Hofmanni I 856, për punë të vokalizmit, meqë Lidëni si formë bazë të *thep-it* vendon një **kepo-* ose **keppo-*. Me shq. *thep* Philippide II 718 bashkon rum. *țepă țapă* «majë (e një kunji), hu, hell; majuk», po këtë më anë tjetër e afron dhe më it. *zeppa* «kunj» *inzeppare* «me mbërthye me kunj; me mbushë, me rrasë». Khs. dhe Rosettin ILR II⁴ 105, 121.

Fjalë e gegërishtes. Cordignano ka edhe *thepe* «thep, cocuzzolo, punta di monte»; Gazulli *thepëe,-e* «bâ me thepa», *njeri thepëc* «qi i ka fjalët e forta, gati me përgjegjë»; Manni i *thepët* «pointed, sharp — edged, keen, tapering»; FGS ka edhe *thepël* f. «ashkël guri a metali» (me sufiks deminutiv *-lë*) dhe mbiemrin *thep,-e* «që të ther me fjalë, që flet me thumba», *vajzë thepe*. Del dhe në toponimi, *Thepi i Meqinës* në Malsi të Gjakovës, Gazetteer 180. — Për historinë e kësaj fjale na duket me rëndësi që -si e kemi shënuar dhe në Li.Po. VIII 79 — pranë trajtës *thep* ka *gëtháp*, më fort si shumë, *gëthapët* e *sfurkut* «brirët e sfurkut», *gëthapët* e *kalasë* «bedenat e kalasë», edhe *gërtháp*, *këtháp* *kthap* «thep» e fem. *kthapë*, sh. edhe Mannin 220, e për formimin Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 72 e 73; te Gazulli, me metaforë, *gëthép* shm. *gëthapë-t* «krrabë drûni a hekuri me vjerrë gjâ më të; hekur e drû e përkulun si grepi; brinat e hagrepit». Në këtë mes *thap* që del si primitivi nga zberthimi morfologjik i *gëtháp* *kthap* etj., do të përfaqësonte njëjës in e mirëfilltë të emrit, e *thep* shumësin metafonik të singularizuar; *thep: thapë* si *thes: thasë*, rreth: *rrathë*, *thek: thakë*. Këtë mendim e përsërit dhe Brăncuși në RESOE I 3-4 313. Me këtë zhvillim të brendshëm të fjalës ndërkaq nuk bie afrimi me lat. *cippus*, e mbase dhe me ind. e vj. *sēpa-h*. Në qoftë se aty hyn dhe arm. *sep*, gjë që duket mjaft afër meç, kemi të bëjmë me një barazim më të gjerë, barazim indoeuropian-dialektor në kuptimin e A. Meilletsë. Duke u nisur nga *thap*, si bazë e fjalës mund të mendohet një **Koip-* — sikundër është përsjatur gjer tani për *thep-in* — : sepse diftongjet indoeuropiane *oi* e *ai* reflektohen në shqipen me *a*, sh. më lart *te dele*, *derr* e *gjaj*. Në lidhje me konsonantin nistor është për të shënuar që trajta e moçme, me *c-* në vend të së sotmes *th-*, ruhet në rum. *teapë*

tapă. Sh. vrejttjet tona në Rev. shkenc. e Inst. Pedagog. dyvjeç; Shkodër 1 16, z.f. Balkanologie II 19.

therpelë f. «*Ruscus aculeatus*, rrushkull». Emër bime; mungon te G. Meyeri, e ka me këtë trajtë FGS. Përdoret në Gjirokastrë. Mitrushi jep për Qeparo të Bregut të Detit *therepël* m., e cila ndihet dhe në anët e Tepelenës. Me këtë trajtë fjala ruhet dhe në toponomastikë: *Therepël-i*, emër i një fshati në Skrapar, shënuar dhe te Gazetteer 180. Apelativi *therpelë* gjan të ketë dalë, me shpërngulje të theksit, nga *thérpëlë*, e të jetë kështu një postverbal i *ther*. Emrin e saj kjo bimë duket ta ketë marrë nga degëzat e gjetheve (filokladiet) që i ka të gjata e me majucë therëse. Me *ther* lidhet edhe një tjetër emër i saj, *thirimí*, f. te Manni dhe *therimí*. Idenë e thumbit përmbajnë dhe disa të tjera emërtime të kësaj bime, si *bar i idhët* e *ferrë çaliqe*, që gjinden te Mitrushi. Edhe në të tjera gjuhë therpela e ka marrë emrin nga majucat therëse të degëzave; khs. rus. *iglica* (*iglá* «gjirpërë»), serbokr. *kôstrika: kostretan* «i kreshpët». Morfologjikisht *therpelë therpël*, nga *thérpëlë*, është zbërthyeshme në *ther-p-ë-lë*, formim me një konglutimat sufiksesh. Nga këto, *-p* është variantja e shurdhët e sufiksit *-b(ë)*, sikundër çfaqet dhe në *kulp kulpër* përkundrejt *kulb-it*; *-lë* është formanti deminutiv i dituri, i shpeshtë bash edhe në emra bimësh a drurësh, si *bungël*, *drédhëlë*, *grozhël*, *hithël*, *kre-sël*, *urrëlë*; khs. për këto sufikse Xhuvani-Çabej 27,65v. *therimí*, me asimilim regresiv të vokalit *thirimí*, duket të jetë një kompozit *ther+mi*. Kjo bimë në mjaft gjuhë e ka emrin nga kjo që mendohet si bar për të larguar miun nga djathi e nga dhjamët. Atëhere *therimí thirimí* do t'i përgjigjej emrit të bimës në shumë gjuhë, si it. *pungitopo*, gjerm. *Mäusedorn* (Maus «mi», *Dorn* «gjemb, ferrë»); gjerm. *Mäusedorn* është një përkthim (kalk), i gr.-lat. *myacanthus* i vitit 1546, sh. Kluge-Götze 383.

thes m. G. Meyeri AS I 38 këtë emër e vendon ndër ato që janë fjalë vendi të shqipes, pa u shprehur më tej, po në Fj. et. 89 e lë të paspieguar. M.E. Schmidt (KZ 50,238 vv.) gjen aty një huazim nga gr. e vj. **σάκκος**, *thes* sipas tij një shumës i singularizuar **sakī*, shumës i sotëm *thasë* refleksi i një neutri shumës. Edhe La Piana (SLA I 30 e 32) e lidh me gr. **σάκκος**; , po anon më fort për një burim të përbashkët për të dy fjalët sesa për një të shqipes nga greqishtja.

Fjalë e mbarë gjuhës, e me mbizotërim të paradigmes *thes* shm. *thasë*, që me traditën letrare më të vjetrën: Buzuku (LX, Jona 3, 6 e 5) e *ϣ mbëluo ndë thes*, e *ndenj ndë hit* «et indutus est sacco, et sedit in cinere», e *ϣ nveshnë ndë thasë*, *η së madhit së tyne djerie mbë të vogëlit* «et vestiti sunt saccis a maiore asque ad minorem». Budi (DC 210b, SC 54) *Sikur një thes i zi e lidhunë kamb e krye, e shtim ndë një thes të komtë*. Bardhi Saccus *Thes*, Sacculus *Thesth*, Rodit mus saccum *Bre miu thesnë*. Bogdani (II 130,4) *U duk Mardokeu deshunë thesit së vet*. «Si vide Mardocheo spogliato del suo sacco». Krahas me skemën më të përhapur, *thes thasë*, me përdorim dhe në dialektet e Greqisë (Reinhold 7), ekziston dhe *thes thesë*, sidomos përbrenda toskërishtes, edhe në Molize të Italisë, Lambertz KZ 52,70. — Sikundër është shtjelluar në Li.Po.VII 172v., edhe më sipër te *rreth*, në sistemin e lakimit, *thes thasë* e *rreth r Rathë*, si e vuri re dhe Hahn (Gramatika 33) me Kamardën (I 201), çfaqen si një anomali, sepse në metaforinë e shqipes shkalla me *-a-* e emrave i përket njëjësit, *-e-*ja shumësit. Prandaj, sikundër e pa separi M.E. Schmidt, te *thes* kemi të bëjmë me shumësin e singularizuar të fjalës, poashtu si te *rreth*. **Ske-**

ma e kryehershme e fjalës ka qenë *thas*, shm. *thes*, pra e përkundërta e së sotmes *thes*, shm. *thasë*. Skema e sotme pas mendimit tonë ka dalë me këtë rrugë, që në të lashtën *thas*: *thes*, *thes*-i i shumësit zuri vend në njëjësin, duke sjellë kështu dy trajta të barabarta për të dy numrat. Në këtë skemë homomorfe, e cila më nuk kryente dot punën e dallimit të njëjësit nga shumësi, trajta e mirëfilltë e njëjësit, *thas*, kaloi në shumës, e kështu lindi e sotmja *thes thasë*. Një gjurmë e njëjësit të hershëm ne e gjejmë te *thath* ose *thas* «thesi» e dialektit të Borgo Erizzos (Arbëneshit) të Dalmacisë. Mendimin e Tagliavinin (f. 298) që kjo të jetë rindërtuar pas shumësit, ne tani e gjejmë të drejtë, po vetëm përsa i përket zhvillimit të ri të gjuhës. Për një fazë më të moçme *thas* s'ka si të jetë e shumësit. Ajo ruan formën e njëjësit të mirëfilltë. — Përsa i përket buriimit të fjalës, *th*-ja e *s*-ja e *thes*-it përkundrejt *s*-së e *kk*-së së gr. *σάκκος* nuk pajton me mënyrën e reflektimit të huazimeve të shqipes nga greqishtja e vjetër. Prandaj më fort se me një element grek kemi të bëjmë me një huazim të përbashkët të shqipes e të greqishtes nga semitishtja, fenikisht *sag* «stofë e komtë, thes, petk zie».

thëllëzë, *fëllënxë fëllânxë* f. «Perdix». Për këtë emër zogu dy janë mendimet kryesore: burim latin, fjalë vendi. G. Meyeri (f. 89, AS IV 95) e bie të ardhur nga lat. *fulica* «bajzë» e më saktë nga një formë e rindërtuar e kësaj, **fulingia*. Mendim i pranuar te Pedersenin (KZ 33,535), i cili rindërton si bazë të fjalës shqipe një *fëllëng-zë*, po përndryshe i vënë në dyshim ose i hedhur poshtë: khs. Meyer-Lübken Gr Gr I² 1052 e 1053; Bariçin I 10v., Treimerin KZ 65,85, La Pianën SLA I 72, Tagliavinin IJ XXV VII 20 e Riv. d'Alb. I fash. 2 f. 201, shënimet tona në Revue de Ling. VII 1 192. Stierin (Nr. 110) është i pari që përsjati dhe hedh poshtë afrimin e *thëllëzë*-s me lat. *fulica*, vë re formimin e fjalës me sufiks -zë dhe e bashkon përbrenda shqipes me *thellë fellë* «me ngjyrë të mbyllët»; khs. dhe Kamardën II 63. Këtë spjegim përsërit pas shumë kohësh dhe M.E. Schmidt (KZ 50,240v.), si duket pa ditur etimologjinë e përparme të Stierit, duke gjetur te *thëllënzë* një formë me bashkim sufiksesh -ën e -zë. Bariçi më parë (I 10v.) e lidhte me verbin *sulem* e më tej me ind. e vj. *śalati* «nxiton» lit. *śūlīś* «galop» etj., më vonë (Arhiv II 81) me ind. e vj. *vihaggas* «zog» etj. Charpentierin (KZ 47,175 vv.) sheh edhe ky te *thëllëzë* një fjalë vendi, po gjen aty si kuptim të parë «larush» dhe e krahason kështu me gr. *παρδάλις* «panterë» me ind. e vj. *prḍakuh* «nepërkë». Fjalë vendi dhe për Schwentnerin (KZ 68,118), i cili e lidh përbrenda gjuhës me *thëllim*. Këtyj mendimi i mbahet dhe Hofmanni te Walde-Hofmann II 286. Sh. dhe Oštirin Arhiv II 298.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi Perdix *Fëllaza*, fonetikiisht pas gjase *fëllâza*. Për sufiks -zë te kjo fjalë sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 109. Etimologjia latine nuk qëndron fonetikiisht dhe s'është afër menç e nga ana e kuptimit. Nga krahasimet e tjera i drejtë është vetëm ai me *thellë fellë*. Thëllëza e ka emrin nga pendët e puplat e murme më të përhimë që e mbulojnë. Edhe në të tjera gjuhë thëllëza e ka marrë emrin së këtejmi. Kështu gjerm. *Rebhuhn* gjerm. e vj. e lartë *repahuon* e afrojnë me let. *ifbe* «thëllëzë» e me nord. e vj. *jarpr* «i murmë» dhe aty vendojnë edhe grupin sllav të serbokr. *jareb* e të rus. *rjabka* «thëllëzë», ku mbase hyn dhe gr. *όρνός* «i errët, i mbyllët». Sh. Walde-Pokorny I 146v., Pokorny I 334, Kluge-Goetze 473, Vasmer REW II 560v., Fraenkel 193v. Nga ngjyra e ka emrin në disa gjuhë dhe pëllumbi, lat. *columba* sll. e vj. kishtare *golōbi*, Berneker I 322, Ernout-Meillet 207, Vasmer REW I

289, me literaturë. Për gr. **πέλεια** «pëllumb i egër» sh. Hofmann GEW 259.

thërpehet «përcitet (dhia)». Ka mbetur e paspieguar te G. Meyeri 10. Bariçi (I 104) mundohet ta lidhë, me anë të një metateze, me *cap*, e këtë më tej me lat. *caper*, isl. e vj. *hafr* «cjav» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Në gegërishten shpeshherë (p.sh. në Hot) *fërpehet*, me ndrimin e ditur të dy spiranteve *th* e *f*. Në Acquiformosa të Kalabrisë *thuprënët* (Rohlf's), me metatezë të konsonanteve e me labializim të *ë-së* në *u* në silabë paratheksore e n'afërsi të labialit. Të tilla forma (*thuprue*, *thyprye*, *thuprye*) jep edhe Gazulli (pranë *thërpye*) për anët e Veriut; mbase ka ndikuar aty *thurpër-a*, si një emërtim metaforik i organit gjenital të cjamin. — Për etimologjinë do pasur parasysh që nga fjalët që shënojnë bashkimin seksual të shtazëve, ato që janë shikuar nga pikëpamja e mashkullit, përmbajnë në thelb idenë e të hypurit a të shkelurit, sh. *hypi*, *këcëj*, *ngalkój*, *ngarkoj*. Ato që kanë lidhje me femrën, e kanë emrin zakonisht nga mashkulli përkatës. Khs. *lopa merr demë*, te Bashkimit *me marrë dem lopët*, *dhitë skjap*, *delet dash* «l'ingravidarsi delle vacche, capre, pecore». Kështu edhe *dhia përcitet* vjen nga *perç* «sqap i patredhur». Një formë paralele me *përcitet* është *thërpehet*. Kjo ka dalë me metatezë nga një **përthehet*. Kjo vetë paraqitet si denominativi i një **përth-i* variante e *përç-it* me spirant *th* të vend të afrikatës. Për këtë ndrim fonetik khs. sidomos Joklin, Balkangerm. u.German. im Alb. 125vv. dhe shënimet tona në Rev. Shkenc. e Inst. dyvjeç. Shkodër I 14v. e 16, Z.f. Balkanologie II 17vv.

thimth m. «thumb i arëzes, i bletës; majë e boshtit të rrotës; thith, majë e sisës, thind». Mungon te G. Meyeri. Jokli (IKU 318v.) *thimth* «thumb i arëzes, i bletës» («pungiglione» te Junggu) e bashkon përbrenda gjuhës me *thind* «sqep; thumb i sisës, thith». Më vonë (IJ XXIV VII 217) ai trajtën *thimc* «pungiglione, punta dell'asse della ruota» që sjell Bashkimi si variante të *thimth-it*, e bashkon me *cimák* «thumbi i bletës; thumbi, mugulli që qit për herë të parë fara e mbjellë kur mbin», e i afron të dyja me femc «thumbi i bletës a i arëzes, thimth».

Sikundër është shtjelluar më lart te *cëmát*, *cëmój*, *cimák*, *cmak*, *femc* e *fëndyell*, afrimi i këtyre fjalëve në mes të tyre si dhe me disa të tjera është i sigurtë. Nga këto, ato më *c-* (*cëmát*, *cëmój*, *cimák* *cmak*) ruajnë një shkallë fonetike më të vjetër, ato më *th-* (*thimth* *thimc*, *thind*, *thimb*, *thëmbónj* e ndonjë tjetër) paraqesin një shkallë zhvillimi të mëtejme. Për burimin e spirantit interdental *th* prej një afrikate khs. Joklin Balkangerm. u.German. im Alb. 125vv. dhe shënimet tona në Rev. Shkenc. e Inst. dyvjeç. Shkodër I 14 v., 16 dhe z.f. Balkanologie II 17vv. Edhe më të reja se format më *th-* janë ato më *f-* (*femc*, *fëndyell*), të cilat rrjedhin nga ndrimi i spiranteve *th:f*; sh. për këtë ndrim BUST SSS XII 1 (1958) 66vv. Në të tilla rrethana, për *thimth* *thimc* do paravenduar një trajtë bazë *thimc*, kjo afërsisht nga një më e moçme **cimc*. Kjo më në gjuhën shqipe nuk ruhet, po ka mbetur e gjallë në rum. *simcea* «thumb, majë; majë mali». Sh. vrejttjet tona në viset e cituara, më parë në Cercetări de lingvistică III. Supliment 1958 (Mélagnes E. Petrovici) 133v. Kështu përjashtohet spjegimi i fjalës rumune nga latinishtja, nga një **senticella* e rindërtuar (prej *sentis* «ferrë, gjemb») ose nga një **summicella* «majëzë» poashtu e rindërtuar (Candrea, Densusianu, Graur).

thjeshtë (i), i *fjeshtë*. Për këtë fjalë G. Meyeri 91 më fort anon të mos pranojë se të pranojë një burim prej lat. *festus* «që i përket së kremtes, që kremton, gazmor», për punë të kuptimeve që s'prijen. Për burimin latin është ndërkaq Meyer-Lübke REW 3267. Jokli përkundrazi (Studien 37v., LKU 190, 214) e lidh fjalën përbrenda shqipes me *kthill kthjell* i *kthillët*, e më tej me sllav. *sinoti* «me ndritë, me shkëlqye» got. *skeinan*, e me ind. e vj. *chāyā* «shkëlqim». Dyshime te Walde-Pokorny II 536. Nuk përmendet ky spjegim te Pokorny I 917.

Kjo fjalë ka bërë një zhvillim në punë të kuptimit. Në gjuhën popullore e në burimet e vjetra mbizotëron ideja e të papërzierit, të kulluarit, të dëlirit (*verë e thjeshtë, ar i thjeshtë, thjesht lesh; njeri i thjeshtë* «nj. i rrafshhtë, i sinqertë, i padjallëzuar, jo madhështor»); te Budi (SC 122) të *kallëzonjë në një të thjeshtë dëshirë, e arrësye të mirë*; te S. Frashëri (në një letër dërguar De Radës, sh. BSS 2, 1954, f. 114) *shumë fjalë... të fjeshta*, te N. Frashëri (Qerbelaja 341, 6, Parathënia e përkthimit t'Iliadës) dhe mjalte *fjesht ëmbëlsirë; të bënemi njerës të fjeshtë; brenda n'urtësit të tija dukej fjeshtë Perëndija; Gjuha jonë duhetë shkruar fjeshtë shqip*. Këtij kuptimi më fort moral, në gjuhën e re, nën ndikim edhe të gjuhëve së huaja, erdhi e iu shtua ideja logjike e së papërbërës, së pandërlikuarës, së lehtës, në shprehje si *çështje e thjeshtë*, në gramatikë *kohët e thjeshta*; ky përdorim del që te S. Frashëri (Shkronjetore), i *thjeshtë* «simple». Me këtë kuptim përdoren dhe neologjizmat *thjeshtë thjeshtësi f.*, *thjeshtëtoj thjeshtësój*, *thjeshtëtim thjeshtësím* m. Ndajfolja *thjesht fjesht* ndërkaq përdoret më fort me kuptimin e parë.

Për etimologjinë ka rëndësi të dihet se cila nga dy variantet fonetike të fjalës është primarja, ajo me *th-* apo ajo me *f-*. Për këtë çështje në parim nuk ka ndonjë rregull fonetike të caktuar, dhe vendimtare në këtë mes për çdo rasë të veçantë është etimologjia, sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. XII 1 (1958) 66. Kristoforidhi ka i *thjeshtë* i *fjeshtë* «**ἀπλός, ἄδολος, γνήσιος**», *thjesht fjesht* «**ἀπλός, ἀδόλος, ἀκράτως; ὀλόκληρος**», dhe trajtën me *th-* e jep si gegërisht e toskërisht, atë me *f-* si të gegërishtes. Kundra këtij mendimi flet rrethana që përballë *fjesht-it* të gegërishtes së Weigandit qëndron i *thjeshtë-i* i Budit. M'anë tjetër për toskërishten e dialektit të tij N. Frashëri, sikundër u pa, jep *fjeshtë; i fjeshtë* dhe në Zagori (M. Totoni, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1, 1962, f. 187). Pra variantja me *f-* në gjuhën popullore ka një përhapje territoriale më të madhe, dhe vetëm në gjuhën e re ka marrë mbizotërimin ajo me *th-*. Për historinë e fjalës do pasur parasysh ndërkaq se pranë i *thjeshtë* e i *fjeshtë* ekziston dhe i *fishhtë*. Kjo tregon se fjala ka dalë idealisht nga një **fillshtë*; zgjerim i *fill-it* me *-shtë*, me rënie të likuidës velare në një grup tri konsonantesh, si *heshtë* nga **hellshtë*, *kashtë* nga **kallshtë*, khs. *heshtë*, *kashtë*. Kështu i *fishhtë* në thelb është një me *-fish* në *dyfish* *trefish* etj., nga *-fijesh*, sh. *-fish*. Kuptimi i të thjeshtit, të dëlirit e të papërzierit ka dalë shpeshherë nga ai i fillit; khs. *ftillój* «nis për diku; shtëllis, spiegoj». me metatezë *ftillój* «sqaroj, shtëllis një punë; rregulloj», *u ftillue moti* «u kthill, u sqarua», *ftillzój* «shtëllis, spiegoj», dhe këto të gjitha prej *fill-it*; sh. *ftillój*, khs. dhe Shp. Bardhin HD XI 254. Kështu edhe përkundrajt simplex *I pātēkeq* i *dëlrirë* të Bardhit Bogdani (I 71,5) ka *Aqa sã drita e Profetisë një filli*. . . «Talmente, che il Spirito profetico semplice. . .». Edhe Tasi te **ἀπλός** përveç i *fish*t jep edhe i *fillt*. Kështu afrimi i fjalëve i *thjeshtë* e *kthill* i *kthillët* që bën Jokli, në analizë të fundit mbetet i drejtë, vetëm se gurra e përbashkët e tyre është *fill-i*. Për i *thjeshtë* i *fje-*

shtë, i fishtë i fillt ndërkaq mbetet e pazgjidhur nëse rrjedhin prej *fill-it* me rrugë metaforike apo prej *fill-it* të vegjve, si shprehje të vegetarisë, ashtu si lat. *simplex* (*plecto*) etj.

Résumé

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XXII

Th

daltë f. «*sorte de hache à deux tranchants ayant d'un côté la forme d'un ciseau ou burin, qui sert à faire des trous dans les objets de bois*», thadrôj «*façonner le bois ou la pierre avec un tel ustensil*». Rapproché par N. Jokl à l'anc. ind. *śastrām* «*instrument tranchant*» *śāsati* «*il coupe*» gr. *κεάζω* «*je fends*» lat. «*castrō, -āre* «*couper, émonder, châtrer, amputer*», ce mot peut dériver d'un *thardhë ou *thardë, comme badhër badër de bardhë, hudhër hudër de hurdhë, et appartenir comme tel à *thar, la forme primaire de ther «*piquer; saigner, tuer*». A thadhër appartient kraha-thadhër (krah «*aile*»), le nom de l'oiseau *accipiter nisus*, par étymologie populaire aussi krahathatë, proprement «*aux ailes sèches*». Dès lors, le gr. *ὄξύπτερος* «*espèce de vautour*» aussi bien que le lat. *accipiter* «*épervier ou faucon*» contiennent plutôt l'idée de l'aigu et du tranchant que celle du véloce, — Un autre composé de thadhër, à travers këthadhër, est kthetër «*griffe, serre*».

thaj «*faire sécher*». Rattaché jusque-là, comme reflet d'un *saus-niō, au groupe lit. *sausas* «*sec*» gr. *αῦω* «*sécher*» lat. *sūdus* «*sec, sans pluie*», etc.. ce verbe, en raison du synonyme thak (dans l'expression ja thaku paratë «*il lui a soustrait tout l'argent*») et de thek «*faire chauffer au feu; griller une tranche de pain*», peut remonter à une base *thaknj, d'un *sauk-niō, et être le proche parent des mots grecs *σαυκός*, *ξηρός*, *Συρακόςιοι*, *σαυχμόν*, *χαχνόν*, *σαθρόν*, *ἀσθενές* (*Hésyche*), et, d'autre part, *αὐχμός* «*sécheresse*» *αὐχηρός* «*sec*». Dès lors, *σαυκός* du dialecte de Syracuse pourrait représenter un reste de l'illyrien d'Italie ou de l'illyrien du dialecte dorique. D'autre part, le nom antique de l'île albanaise de Sazani, Sason *Σλωών* peut remonter à la base *saus- *sas- susdite.

thalb m. voir thelb.

thanë f. «*cornouiller, cornouille*». Des rapprochements étymologiques proposés jusqu'à présent: lat. *cornus* gr. *κράνος* ou alb. thaj «*faire sécher*» (G. Meyer), ce même groupe et irl. *congan* «*corne, cor*» (Pedersen), i thantë «*maigre, mais d'une santé parfaite* et i thatë «*furoncle, abcès*» (Jokl), seul celui avec l'irl. *congan* subsiste. Forme de base pourtant *kongā, groupe ng évolué à n.

i thartë, i tharët «*acide, aigre*». Apparenté, selon G. Meyer, à l'all. herb «*acre, âpre, aigre*» Harm «*affliction*», selon Pedersen au lat. *acerbus*, selon Jokl, avec tharm «*levain*» et tharb «*acide*», au lit. *szármas* letton *sarms* «*lessive*», selon M. G. Restelli à l'all. *sauer* «*aigre, sur, acide*» lit. *sūras* «*salé*» vieux sl. syrъ «*fromage*», ce mot se révèle être un adjectif

verbal, de *thar, me tharë tamblin «faire cailler le lait en yougourt». thar représente la forme première de ther «piquer; saigner, tuer». Premier sens de thar «couper», et de i thartë «tranchant»; cf. dimër i thartë «hiver rigoureux», fjalë të tharta «mot âpres, mordants». Le roum, sarbād au sens «acide, aigrelet, insipide» semble refléter l'alb. tharbët.

thek «faire chauffer au feu; griller une tranche de pain», thekem «se chauffer au feu ou au soleil». Ni de l'it. seccare (G. Meyer) ou secco (Brugmann), ni du lat, siccare (Meyer-Lübke). Mot des sources indigènes, mais pas le proche parent de thëngjill «charbon» et de dol (1) ofangë «luciole» et en outre de l'anc. ind. śōcati «il brille, il luit, il brûle» (Barić). Forme métaphonique de thak et en dernière analyse de thaj, ci-dessus examinés. thek est employé aussi au sens métaphorique de «toucher, émouvoir», i thekshëm «touchant, émouvant».

thekën thekër f. «seigle». Non pas d'un lat. sécale pour secale, comme on opinait depuis G. Meyer, mais le même mot que theknat thekrat, le pluriel de thek «frange», employé comme singulier (Jokl). Cf. thakët e grunit «les arêtes de l'épi du grain».

thelb thalb m. «partie comestible des fruits à écorce (noix, amande, châtaigne; gousse d'ail), au sens figuré «quintessence». Aucun rapport ni avec le frioul sepe «noyau» (G. Meyer) ni avec l'alb. bërthamë «noyau des fruits» (Barić). thelb représente le pluriel métaphonique, et singularisé, de thalb. Si on admet une alternance th : f, fréquente en albanais, on peut partir d'un *falb *felb comme forme de base et rattacher ceci à l'indo-eur. *sphel-, dans anc. ind. phálati «il crève, il se fend» gr. σφαλάσειν τέμνειν, κεντεῖν, alb. spalten, etc. C'est pourtant une solution hypothétique. A thelb semble appartenir thebël «petite pièce de pierre, mince et plate».

thelë f. : voir felë.

thellë, fellë (i) «profond; foncé», thellë «profondément, bien avant dans...», thellësi f. «profondeur», thellësirë thellësinë thellinë f. «lieu profond dans l'eau», thellój «approfondir, creuser de dedans; foncer, en parlant d'une couleur». Ni du groupe de l'anc. ind. śūši- «creux, cavité, fosse», ni de celui du gr. κοῖλος «creux» lat. cavus, comme on est d'accord depuis G. Meyer, ni apparenté au gr. θέλυμα pl. «fondements (des choses)», homér. θέλυμος «extirpé jusqu'à la racine», comme un élément centum de l'albanais (La Piana). Des deux formes du mot, fellë a toutes les chances d'être la première, et des diverses acceptions, celle de «creux» est l'originale. Cf. à ce propos udhë e thellë «chemin creux», gërféj et zgërfëj mpl. «caverne à deux entrées», zgafelle f. «galerie souterraine, grotte, caverne», zgafullój «creuser une fosse», fyell «flûte, chalumeau, tuyau de l'appareil distillatoire» fyell i këmbës «tibia» fyell η mjalti «favum mellis» (Buzuku), fejet e hundës «narines», etc. De l'indo-eur. *sphel- «fendre, faire voler en éclats, écorcher, arracher», où rentrent entre autres le gr. σφαλάσειν τέμνειν, κεντεῖν, l'all. spalten «fendre», etc. A ce même groupe appartient à notre avis σπήλαιον σπήδυξ «antre, caverne», resté inexplicé jusqu'à ce jour.

thembër f. «talon, talon d'un bas; croute latérale du pain, morceau de pain. Ni apparenté au gr. θέναρ «paume de la main, plante du pied» (Ca-

marda), ni emprunté au lat. femur «cuisse» (G. Meyer), qui s'éloigne du sens et, de plus, n'a pas survécu en roman. Signification originale à peu près «courbé, ployé».

thep m. «rocher à pointe», thepis «rendre pointu, hispide». Rapproché par Jokl à cep «coin, angle; épaule; bec; sommet, pointe» et step «pointe» (c : th), par Lidén à l'arm. sep «rocher à pointe», ce mot se présente aussi sous la forme thap, dans gëtháp, au pluriel gëthapët e sfurkut «les pincés du scorpion» gëthapët e kalasë «les crénaux d'une forteresse», dans gër-tháp këtháp kthap, synonymes de thep, etc. En raison de ces faits, thep résulte être un pluriel singularisé, tout aussi comme rreth, thes, thek. Si les rapprochements mentionnés subsistent tous les deux, il y a lieu à admettre une isoglosse indo-européenne dialectale au sens d'A. Meillet. Alb. thap d'un *koip-, indo-eur. ai: alb. a comme dans dele, derr, gjaj. De l'albanais provient probablement le roum. țeapă tapă «pointe d'un coin, pieu, pal, piquet, broche de fer pour faire rôtir la viande; pointu».

therpelë f. «*Ruscus aculeatus*, fragon», aussi therepël m., Therepeli nom de village. Doit remonter à thërpëlë et être dérivé de ther «piquer; saigner, tuer», à cause des phylloclades pointues et piquantes. Une pareille désignation dans le russe iglica, le serbo-cr. kostrika, etc., tous noms de la même plante. A l'it. pungitopo et l'all. Mäusedorn qui est un calque du gr. -iat. myacanthus, correspond plus précisément un autre nom albanais du fragon, therimí thirimí, un composé de ther et mi «souris». Du point de vue morphologique thërpëlë (avec therpelë) est à analyser en ther-p-ë-lë, suffixe-p- comme dans kulp kulpër «clématite sauvage» face à kulb même sens, -lë le suffixe diminutif bien connu, fréquent aussi dans les noms de plantes.

thes m. «sac». Plutôt que d'un emprunt au gr. σάκος (M.E. Schmidt) il s'agit d'un mot de source commune (phénicienne) avec le nom grec (La Piana). Comme a été remarqué par M. E. Schmidt, thes représente le pluriel singularisé du nom. Le paradigme original a été thas: pl. thes, donc le contraire de l'usage actuel.

thëllëzë, fëllënxë fëllänxë f. «perdrix». Une dérivation du lat. fulica, par reconstruction *fulingia, soutenue par G. Meyer et beaucoup de savants après lui, est insoutenable pour de multiples raisons. Le même vaut pour les diverses combinaisons indo-européennes, de Barić, Charpentier et Schwentner, malgré l'approbation de cette dernière (thëllím) par Walde-Hofmann II 286. La seule étymologie convaincante est celle de Stier, répétée plus tard par M. E. Schmidt: thëllëzë fëllënxë fëllänxë un dérivé de thellë fellë au sens de «foncé», aux suffixes -anë-zë. Pour une telle dénomination de la perdrix on peut confronter l'all. Rebhuhn face à l'anc. norr. jarpr «brun», etc.

thërpehet, dit de l'accouplement des chèvres. Aucun rapport avec cap «bouc», comme opinait Barić. Du fait que l'accouplement des femelles du bétail est appelé souvent par le nom du mâle respectif (me marrë dem lo-pët, dhitë skjap, delet dash «l'ingravidarsi delle vacche, capre, pecore», Bashkimi) et que notamment l'accouplements des chèvres est dit aussi përcitet, de përc «bouc non châtré», thërpehet provient, par métathèse, d'un *përthehet. Cette dernière forme se présente comme un dénominateur

de *përth, variante phonétique de përc à spirante interdentale pour la mi-occlusive.

thimth m. «dard des abeilles, des guêpes, aiguillon; extrémité de l'essieu; pointe du mamelon», a été à bon droit rattaché par Jokl à thind «bec», thimc «pungiglione, punta dell'asse della ruota», à cimák «aiguillon de l'abeille; pousse de la semence» et à femc «dard des abeilles, des guêpes». Dans ce même groupe sont, en outre, à ranger cëmát «cheville, espart, petit coin; broche subtile servant à coudre du cuir, des courroies, des sacs, etc.», më cëmon «j'ai des douleurs (de coeur, etc.)», fëndyell «alène». De ces mots, comme a été établi par le savant mentionné ci-dessus, ceux à mi-occlusive initiale conservent une forme phonétique antérieur à celle des cas à spirante interdentale, tandis que celles à f- représentent une phase encore plus évoluée. D'une forme plus ancienne de thimth thimc provient le roum. simcea «pointe, cime, sommet; aiguillon, épine», qu'on a fait remonter jusque-là à un lat. *senticella de sentis «buisson, ronce», ou à un *summicella.

thjeshtë (i), i fjeshtë «pur, simple». L'idée d'une origine latine (festus «de fête; qui célèbre la fête, oisif, joyeux») jetée par G. Meyer, a été adoptée plutôt par Meyer-Lübke que par lui-même. Jokl le rattache à kthill kthjell «rendre serein» kthillët kthjellët «clair, serein». Employé dans le sermon populaire au sens de «pur, non altéré ou mélangé; sincère», ce mot a évolué aussi à l'acception «simple.» Des deux variantes phonétiques, celle à f- prédomine dans les dialectes, mais il existe aussi, auprès d'elle, i fishtë et i filltë. C'est un dérivé à suffixe -shtë de fill «fil», idéalement un *fillshtë. i fishtë est au fond le même mot que -fish dans dyfish «double» trefish «triple», ceci de -fijesh, l'ablatif pluriel de fill. Ici rentrent encore tfillôj «mettre en route, envoyer; expliquer», par métathèse ftillôj «éclaircir, développer» ftillzôj même sens. Peut-être un terme du métier de tissage.